



NR:03/2018 Nr.prot: 48/2018

Lenda Nr:037/2018

Për:	NTG BLENDI Prishtinë
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar Komuna Suharekë
Nga:	Bujar Kuçi, shef i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për kërkesën për rishqyrtim të datës:30/07/2018 nga OE NTG BLENDI Prishtinë
Datë:	31/07/2018



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 30.07.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik NTG BLENDI, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me mjete konkretizimit -paisje me kabinete**, me Nr. Brendshëm 62418037121, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik NTG BLENDI e datës: 30.07.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me mjete konkretizimit -paisje me kabinete”**, me Nr. Brendshëm 62418037121, kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 25.07.2018 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 25.07.2018;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik NTG BLENDI me datë 30.07.2018, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me mjete konkretizimit -pajse me kabine", me Nr. Brendshëm 624 18 037 121. Autoriteti Kontraktues, ka vlerësuar edhe njeher oferten e OE NTP ABETARE dhe jep kete arësyetim per kërkesën tuaj:

-Sa i perket pretendimeve per çmimi jo normalisht te ulët, ne kemi respektuar Nenin 3 pika 1 dhe 2 të "Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët", sepse OE nuk ka plotësuar kushtin e nenit 3 pika 1.i si OE që ka çmimin Jo-Normalisht të ulët sepse:

Sipas Neni 3 pika 1 i, per OE ABETARE çmimi i ofruar **NUK** është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm (shiko tabelen);

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik te pergjegjshem	Vlera totale e ofertës
2	ABETARE	39.491,25
4	VITECH SHPK	49.985,25
5	NTG BLENDI	45.587,50

-Megjithate ne në zbatim të Nenit 3.2 të rregullave për cmime jo normalisht të ulëta (3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht te ulët për arsye të tjera nga ato te parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së), kemi kërkuar sqarime të cilat OE i ka ofruar.

-Sa i përket pretendimit tjetër se OE ABETARE nuk ka nënshkruar formularin C pjesa 1 e tenderit kjo nuk qëndron fare sepse i njëjti është i nënshkruar dhe i vulosur dhe është dorëzuar sipas kerkesave të LPP-së, po ashtu në proces të hapjes Formulari C, është nënshkruar nga një përfaqësues i OE tjetër prezent në hapje (pa vrejte ne procesverbal) dhe për ne ky pretendim është i pakuptueshëm.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

**Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.
Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

